



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

ZBATIMIN E LIGJIT NR. 9669, DATË 18.12.2006

“PËR MASAT NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”

(i ndryshuar)

Ndërmjet

MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË
BARABARTA

Nr. 2322 Prot. 21.11.08

MINISTRISË SË BRENDSHME

Nr. 9895 Prot. 12.08

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Nr. 8678 Prot. 05.12.08

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

Nr. 4200 Prot.
4.12.08

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS

Nr. 8220 Prot.

Sot më datë 19/11/2008, midis Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të quajtura Palë, nënshkruhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi:

Në mbështetje të nenit 5, 6, 7, dhe 8 të Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar),

KREU I DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është angazhimi i palëve, për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.

Neni 2

Objekti

Objekt i kësaj marrëveshjeje është bashkërendimi i përpjekjeve të përbashkëta për të siguruar bashkëpunimin e strukturave përkatëse të autoriteteve përgjegjëse, për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar).

KREU II

DETYRIMET E PALËVE

Neni 3

Detyrimet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nëpërmjet strukturës përgjegjëse "Për masat ndaj dhunës në familje", në funksion të zbatimit të detyrimeve të saj si autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar), angazhohet që :

3.1. Të drejtojë dhe bashkërendojë punën me të gjitha institucionet e tjera të linjës për zbatimin e këtij ligji.

3.2. Të organizojë takime të rregullta një herë në gjashtë muaj, me përfaqësuesit e autoriteteve përgjegjëse të linjës, ku diskutohen dhe merren vendime për çështje që kanë të bëjnë me hartimin, rishikimin e politikave apo nevojën e ndërhyrjeve në legjislacionin për masa ndaj dhunës në familje; ku analizohen dhe nxirren rekomandime për raporte të ndryshme që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Tryeza drejtohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3.3. Të ndjekë zbatimin e Planit të përbashkët të punës të hartuar në çdo fillim viti.

3.4. Të mbledhë dhe kategorizojë informacionin e dhënë nga autoritetet përgjegjëse të linjës, çdo 3 muaj për rastet e dhunës në familje, sipas pikave të "Formularit Tip" që do të hartohet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

3.5 Të bashkëpunojë me pushtetin vendor për ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje, qendrave sociale dhe të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare, qendrave të rritjes së fëmijëve, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë, ose kur prindërit e tyre kryejnë vepra dhune ndaj njeri-tjetrit, si dhe të koordinimit të punës me ato ekzistueset.

3.6 Të organizojë trajnimin e vazhdueshëm me punonjësit e strukturave përgjegjëse që trajtojnë rastet e dhunës në familje.

3.7 Të licensojë OJF-të e ndryshme që ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit.

3.8 Të organizojë me brezin e ri, në shtetin shkollor dhe jashtë tij, fushata sensibilizuese për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje me qëllim edukimin me vlerat dhe normat e sjelljes në familje, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse të linjës, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vend.

Neni 4

Detyrimet e Ministrisë së Brendshme

Ministria e Brendshme, në funksion të zbatimit të detyrimeve të saj si autoritet përgjegjës i linjës për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar), angazhohet që :

- 4.1 Njëpërmjet strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, t'i dërgojë MPÇSSHB çdo tre muaj informacionin e nevojshëm për rastet e dhunës në familje, me të dhënat sipas pikave që përmban "Formulari Tip" që do të hartohet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
- 4.2 Në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore të sigurojë funksionimin e linjës telefonike 24 orëshe të ngritur pranë këtyre njësive .
- 4.3 Njëpërmjet strukturave përkatëse pranë Drejtorive Rajonale të Policisë, të mundësojë dërgimin e viktimave të dhunës në familje në qendrat sociale dhe të rehabilitimit.
- 4.4 Të organizojë trajnimin e vazhdueshëm të efektivave të policisë, për rastet e dhunës në familje.

Neni 5

Detyrimet e Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, në funksion të zbatimit të detyrimeve të saj si autoriteti përgjegjës i linjës për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar), njëpërmjet strukturave të saj angazhohet që :

- 5.1 Në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Zyrën e Administrimit Gjyqsor , të sigurojë mbrojtje ligjore falas për viktimat e dhunës në familje.
- 5.2 Ti dërgojë MPÇSSHB çdo 3 muaj një informacion me të dhëna për rastet e dhunës në familje, sipas pikave që përmban "Formulari Tip" që do të hartohet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, bazuar në të dhënat e mbledhura nga strukturat përkatëse të administratës gjyqsore të rretheve gjyqsore.

Neni 6

Detyrimet e Ministrisë së Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë, në funksion të zbatimit të detyrimeve të saj si autoritet përgjegjës i Linjës për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet Familjare" (i ndryshuar), nëpërmjet strukturave të saj angazhohet që:

- 6.1 Të krijojë kapacitetet e duhura për të ofruar trajtimin ambulator dhe spitalor të viktimave të dhunës në familje.
- 6.2 Të krijojë mundësinë për pajisjen me raport mjekësor të posaçëm për pacientët të cilët kanë pësuar dhunë në marrëdhëniet familjare.
- 6.3 Të krijojë një regjistër të posaçëm të titulluar "Për rastet e dhunës në familje", ku do të regjistrohen viktimat e dhunës në familje të trajtuar në qendrat spitalore, dhe në qendrat shëndetësore në bashki dhe komuna.
- 6.4 Të krijojë edhe mundësinë e dhënies së ndihmës psikologjike për viktimat e dhunës në familje, në qendrat e ofrimit të shërbimit shëndetësor.
- 6.5 Ti dërgojë MPPÇSSHB çdo tre muaj informacionin e nevojshëm për rastet e dhunës në familje, me të dhënat sipas pikave që përmban "Formulari Tip", që do të hartohet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Neni 7

Detyrimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si autoritet përgjegjës i linjës për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar), nëpërmjet strukturave të saj angazhohet që :

- 7.1 Në të gjitha institucionet shkollore të arsimit parauniversitar të trajtohen problemet e dhunës në familje në kuadër të veprimtarive kurrikulare dhe ekstrakurrikulare.
- 7.2 Shërbimi Psikologjik Shkollor të trajtojë me përparësi probleme të dhunës në familje si dhe të bashkërendojë veprimet për evidentimin dhe parandalimin e dhunës në familje me strukturat në nivel lokal të MB, MSH, MPÇSSHB.
- 7.3 Të orientojë që në Fakultetet e Shkencave Sociale dhe në të gjitha Fakultetet e Mësuesisë, të arsimit të lartë publik dhe privat, trajtimi i problemit të dhunës në përgjithësi dhe i dhunës në familje të bëhet pjesë e kurrikulave të tyre, nëpërmjet moduleve apo cikël leksionesh.
- 7.4 Instituti i Kurikulave dhe Trajnimit të përfshijë në botimet e veta, në ndihmë të mësuesit, trajtimin e moduleve të veçanta për dhunën në familje
- 7.5 Ti dërgojë MPÇSSHB çdo tre muaj informacionin e nevojshëm për rastet e dhunës në familje, me të dhënat sipas pikave që përmban "Formulari Tip", që do të hartohet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Neni 8

Detyrime të përbashkëta

Autoritetet përgjegjëse të linjës në funksion të detyrimeve që rrjedhin për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar), angazhohen që:

- 8.1.Të hartojnë çdo fillim viti një plan pune të përbashkët duke u mbështetur në detyrat që rrjedhin nga Ligji Nr. 9669 dt.18.12.2008 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar) .
- 8.2.Të parashikojnë çdo vit në projekt- buxhetin e tyre një zë të veçantë për zbatimin e aktiviteteve konkrete për dhunën në familje.
- 8.3.Të dërgojnë pranë strukturës përgjegjëse për masa ndaj dhunës në familje në MPÇSSHB, informacione të tjera lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 9669 dt.18.12.2008 "Për masa ndajdhunës në marrëdhëniet familjare" sipas fushave të veprimtarisë së tyre, në afatin dhe formën e kërkuar, në formë shkresore dhe/ose elektronike.

Neni 9

Dispozita përfundimtare

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve mes palëve.

Neni 10

Hyrja në Fuqi, Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët, dhe është e vlefshme për një kohëzgjatje të pacaktuar.


Hartuar në Tiranë, më datë 14 / 11 / 2008.


Për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta **Ministri**


Anastas Duro



Për Ministrinë e Brendshme **Ministri**

Bujar Nishani
Ne mungese dhe me porosi

Gent Strazimiri



Për Ministrinë e Drejtësisë **Ministri**

Enkelejd Alibeaj
Ne mungese dhe me porosi
Zëvendësministri

Viktor Gumi



Për Ministrinë e Shëndetësisë **Ministri**

Anila Godo
Ne mungese dhe me porosi
Zëvendësministri

Arben Ivantaj



Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës **Ministri**


Fatos Beja

